



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË FERMERËVE
(PËR KOMPENSIMIN E DËMEVE)**

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të fermerëve për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (breshëri, era dhe shiu) dhe dëmet e shkaktuara nga mungesa e shitjes së perimeve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, të cilët kanë aplikuar sipas thirrjes publike për aplikim Nr.12-320-43053 të datës 08.09.2020 të shpallur nga Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në këtë përbërje:

1. Gafurr Hetemi, zyrtar për çështje pronësoro- juridike Kryesues
2. Azem Arifi , Zyrtar në Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
3. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

- Bën shqyrtimin e ankesave të fermerëve për ndarje të subvencioneve të cilët kanë aplikuar sipas thirrjes publike për aplikim Nr.12-320-43053 të datës 08.09.2020 të shpallur nga Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural brenda afatit prej 10 ditësh pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 , kritereve të përcaktuara në shpalljen publike dhe legjislacionin në fuqi.
- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit
- Vendimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit si dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 320-53243

Lipjan, më 29-10-2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

